



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 118, datë 27.10.2022

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5, RRUGA "DAVID SELENICA", PALLATI NR. 18, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" (Titulli 3, Bashkëpronësia, Neni 199 dhe vijues), të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, të raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr. 471/57 Prot., datë 24.10.2022, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit të pallatit Nr.18, Rruga “David Selenica”, të ndodhur në Njësinë Administrative Nr.5, sipas aneksit nr. 1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.18, RRUGA "DAVID SELENICA"

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
1	FEHIM KALEMASI	4	2+1
2	DITURI BRUKA	3	2+1
3	NDREC ÇOKAJ	6	3+1
4	DITURI TUFINA	4	2+1
5	MIMOZA KORRI	2	1+1
6	PETRIT ÇEVELI	4	2+1
7	THANAS NIKA, NAUNKA NIKA	2	1+1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834 / prot.
9

Durrës, më 08.11.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.118 datë 27.10.2022 :

Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr 5, Rruga “David Selenica”, pallati nr 18 i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

